



EMISION TELEVIZIV - ANALIZË E FUSHATËS ZGJEDHORE NË KOSOVË

Më 3 shkurt 2021, drejtori ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković, ishte mysafir në RTK 2 dhe bisedoi me bashkëbiseduesit e tij Nexhmedin Spahiu dhe Gzim Baxhaku rreth fushatës zgjedhore dhe çfarë pritet prej saj.



EMISION TV

NUMRI I ZVOGËLUAR I QENDRAVE TË VOTIMIT, VOTIMIN VETËM ME DOKUMENTE TË KOSOVËS

Më 5 shkurt 2021, z. Radaković ishte mysafir në radio Kontakt Plus dhe foli për fushatën zgjedhore, për situatën me votuesit dhe qendrat e votimit në veri të Kosovës. Ai gjithashtu deklaroi se OSBE nuk do të monitorojë këto zgjedhje dhe se ai pret që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të organizojë vetë zgjedhjet dhe të tregojë se mund ta bëjë atë në mënyrën më të mirë të mundshme.

TRAJNIMI



TRAJNIMI PËR VËZHguesIT AFATSHKURTËR TË ZGJEDHJVE

"Demokracia në veprim" është një koalicion i dhjetë organizatave joqeveritare që monitorojnë zgjedhjet në të gjithë Kosovën. OJQ ACDC, si anëtare e këtij koalicioni, ishte përgjegjëse për katër komuna në veri të Kosovës (Mitrovica e Veriut, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq). Më 8 shkurt 2021, OJQ ACDC organizoi trajnim për vëzhguesit afatshkurtër të zgjedhjeve në Mitrovicë dhe Leposaviq. Trajner ishte z. Aca Mitiq.



EMISION TELEVIZIV – “DEMOKRACIA NË VEPRIM”

Më 8 shkurt 2021, z. Radaković ishte musafir në RTV MIR. Z. Radaković foli për zgjedhjet e ardhshme dhe vuri në dukje se numri i votuesve dhe vendvotimeve është zvogëluar ndjeshëm, se sa njerëz organizojë/angazhojë "Demokracia në Veprim" si vëzhgues, dhe si do të punojnë ata ditën e zgjedhjeve.

EMISION TELEVIZIV – “DEMOKRACIA NË VEPRIM”

Më 13 shkurt 2021, z. Radaković ishte musafir në Radio Mitrovica Veriore. Dushan Radaković, organizata joqeveritare e të cilit do të monitorojë pjesërisht zgjedhjet si pjesë e Demokracisë në Veprim, i tha RTS-së se zgjedhjet në komunitetet serbe do të organizohen si më parë, dhe deklaroi se numri i votuesve është zvogëluar për 16,000.



DITA E ZGJEDHJEVE 14.02.2021

Fotografitë e zgjedhjeve.

NDRYSHIMI I LOGOS

OJQ ACDC paraqet logon e re të organizatës. Si pjesë e krenimit të dhjetë vjetorit, OJQ ACDC vendosi se ishte koha për disa ndryshime të vogla që do të çonin në përmirësimin e organizatës dhe njohjen më të madhe të saj.

SPORAZOOM - “ZGJEDHJE TË JASHTËZAKONSHME, VOTIM I RREGULLT”

Më 17.02.2021, Drejtori Ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković ishte musafir në emisionin “Sporazoom”.




EMISION TELEVIZIV – “DEMOKRACIA NË VEPRIM”

Më 17 Shkurt 2021, Drejtori Ekzekutiv i OJQ-së ACDC, Dushan Radaković, ishte musafir në ambientet e KQZ-së në Graçanica në debatin mbi kombinatorikat parazgjedhore.

EMISION TV

“DEMOKRACIA NË VEPRIM”

Më 23 shkurt 2021, Z. Radaković foli për Kosova Online dhe theksoi se qeveria e ardhshme duhet të adresojë çështjen e dialogut dhe çështjen e Presidentit të Kosovës në të njëjtën udhë, si dhe çfarë mund të pritet nga Qeveria aktuale, dhe nëse është e mundur që të përsëritet i njëjti skenar kur qeveria ra pas vetëm 50 ditësh.



WEBINAR – “MBROJTJA E TË DREJTAVE TË PRONËS NË KOSOVË”

Më 25 shkurt 2021, OJQ ACDC organizoi një webinar takim për pronën në Kosovë. Pjesëmarrës në takim ishin z. Predrag Milković, avokat dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe z. Shkelzen Barjaktari, Departamenti i Informacionit, Agjencia e Krahasimit dhe Verifikimit të Pronave të Kosovës. Projekti mbështetet nga UNMIK. Panelistët folën për çështjet e pronës në të gjithë Kosovën dhe se si ato mund të zgjidhen në të ardhmen.